

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
(Zgjidhjet)**

P10

Data 19/06/2022

Detyra 1

Ju jeni një menaxher auditimi në firmën ligjore të auditimit Aliu & Partnerët. Ju jeni caktuar në auditimin e D&F Shpk, një kompani e cila filloi tregtimin më 23 mars 2021. Viti financiar përfundon me 30 prill 2022.

Aktiviteti i vetëm i kompanisë është grumbullimi dhe riciklimi i mbeturinave nga klientët vendas dhe bizneset e vogla. Ai nuk merret me mbeturinat nga bizneset më të mëdha apo nga subjektet që prodhojnë mbeturina të konsideruara si të rrezikshme.

Kompania filloi të funksionojë pasi fitoi një tender nga një autoritet vendor që dëshironte të kontraktonte këto aktivitete të cilin më parë e drejtonin vetë. Ky vendim ka ngjallur një kundërshtim të konsiderueshëm të komunitetit lokal dhe politik ndaj asaj që kundërshtarët pretendojnë se është “privatizim” i shërbimeve jetike. Në dokumentin e tenderit, D&F u zotua të jetë “e ndjeshme” ndaj perceptimeve të komuniteteve në lidhje me operacionet e saj.

Kompania krijon shumicën dërrmuese të të hyrave të saj nga katër burime të ndryshme, si më poshtë:

1. Abonimet vjetore ose mujore nga pronarët e shtëpive dhe bizneset e vogla që dëshirojnë të grumbullojnë periodikisht mbeturinat ose riciklimin e tyre. Një sërë paketash janë në dispozicion në varësi të sasisë së mbeturinave të prodhuara; shkalla në të cilën është e riciklueshme; dhe distanca që duhet të kalojë D&F për ta mbledhur atë. Për momentin, D&F gëzon monopolin e ofrimit të këtyre shërbimeve dhe autoritetet vendore kanë rënë dakord të mos licencojnë asnjë grumbullues tjetër për të paktën tre vjet, nëse D&F nuk shkel kushtet e kontratës. Për më tepër, D&F gjithashtu ofron transport për klientët që kanë kërkesa të rastësishme për asgjësimin, për shembull, për shkak të zhvendosjes nga shtëpitë.

2. Ofrimi i “qendrave grumbulluese” ku çdokush mund të sjellë mbeturina ose materiale riciklimi. Një tarifë paguhet në varësi të sasisë së mbeturinave ose riciklimit të përfshirë. Disa sende, të tilla si pajisjet elektrike të hedhura, mund t'i hidhen klientit pa pagesë. D&F më pas kompensohet sipas një skeme qeveritare (shih pikën 4 më poshtë).

3. D&F sorton dhe shet çdo material që mund të riciklohet në një nga dy kompanitë e specializuara në riciklimin aktual të produkteve të ndryshme si plastika, metalet, druri, letra etj.

4. D&F ka të drejtë për një subvencion të konsiderueshëm nga qeveria, i cili paguhet çdo tremujor (në fund të tremujorit) dhe bazohet në një formulë të ndërlikuar që shpërblen kompaninë si për sasinë ashtu edhe për përqindjen e materialit të mbledhur dhe dërguar më pas për riciklim, dhe për minimizimin e përdorimit të deponisë së mbeturinave dhe djegies. Kompania përfiton tarifa specifike në lidhje me artikujt elektrik të përpunuara për riciklim.

Përveç shpenzimeve të administratës si pagat dhe mëditjet dhe shpenzimet e funksionimit të automjeteve, shpenzimi kryesor që kompania kryen është kostoja e deponisë dhe djegies që ajo merr nga ofruesit e tjerë të shërbimeve të specializuara. Ajo gjithashtu ka pasur shpenzime të mëdha të interesit në vitin e parë të funksionimit të saj, sepse mbledhja e të hyrave ka rezultuar të jetë më e vështirë se sa ishte parashikuar. Gjithashtu, vetëm dy pagesa subvencioni janë pranuar gjatë vitit të parë.

Dosja aktuale e auditimit vë në dukje se sistemet e kompanisë janë përshkruar nga ekipi i auditimit dhe se testet hap-pas-hapi janë kryer në këto sisteme. Ciklet e përshkruara dhe të dokumentuara nga ekipi i auditimit përfshijnë ciklin e të hyrave/të arkëtueshmeve; ciklin e shpenzimeve/pagesave; ciklin e pagave/akrualeve. Nuk janë vërejtur probleme të veçanta sa i

përket cikleve të shpenzimeve apo pagave, por cikli i të hyrave është vërejtur se ka disa dobësi. Ndër dobësitë e vërejtura ishin këto:

1. Grumbullimet periodike të plehrave nga klientët pothuajse nuk pezullohen, pavarësisht faktit se disa klientë nuk arrijnë të paguajnë me kohë. Transportet e veçanta shpesh u ofrohen klientëve pa u marrë paraprakisht pagesa dhe pothuajse nuk bëhet asnjë përpjekje për mbledhjen e mëvonshme të borxhit.
2. Stafi shpesh u lejon klientëve zbritje ose "marrëveshje speciale" për grumbullimin e mbeturinave, por kjo duket se ndodh pa asnjë formë autorizimi, miratimi ose regjistrimi sistematik.
3. Mbledhja e tarifave në "qendrën grumbulluese" duket të jetë jashtëzakonisht e rastësishme. Konsumatorët duhet të deklarojnë atë që kanë dhe ta paguajnë te portat (që janë një lloj mekanizmi rrotullues për automjetet) dhe kjo supozohet të kontrollohet nga një pjesëtar i stafit në zonat e shkarkimit. Vëzhgimet nga ekipi i auditimit sugjerojnë se portat shpesh lihen të hapura dhe të pambikëqyrura, për shembull gjatë pushimeve të stafit, dhe nuk ka asnjë përpjekje për të barazuar sasinë e materialit të mbledhur me pagesat e marra.

Kur këto dobësi u diskutuan me menaxherët e seksioneve të ndryshme, të gjithë ata përmendën se ishin nën udhëzime të rrepta për të lehtësuar klientët në çdo mënyrë të mundshme, sepse menaxhmenti i lartë u kishte komunikuar atyre nevojën për të shmangur ankesat e klientëve tek autoritetet lokale, në media, apo në ndonjë mënyrë tjetër. Me sa duket, kjo lidhet me kundërshtimin politik dhe të komunitetit për "privatizimin" e shërbimit në radhë të parë. Menaxherët e seksionit thanë gjithashtu se ata besonin se menaxhmenti i lartë ishte i kënaqur me situatën aktuale dhe nuk kishte gjasa ta rishikonte atë çfarëdo që mund të thoshin auditorët!

Për të marrë subvencionin, autoritetet vendore sapo kanë njoftuar se, me efekt nga tremujori i përfunduar më 31 dhjetor 2022, do të kërkojnë një raport sigurie për pretendimet e subvencionit nga kompania. Ky raport duhet të sigurojë siguri për vërtetësinë e pretendimeve në lidhje me sasinë e materialit të mbledhur, të dërguar për riciklim dhe të asgjësuar në mënyra të tjera. Ju është kërkuar të përgatitni këtë raport në baza tremujore.

Kërkohet:

- (a) Analizoni në mënyrë kritike vështirësitë që mund të lindin në kryerjen dhe përfundimin e këtij auditimi që rrjedhin nga fakti se është viti i parë që kompania ka tregtuar dhe pasqyrat financiare mbulojnë një periudhë prej më shumë se një viti. **(12 pikë)**
- (b) Vlerësoni katër rreziqet e biznesit me të cilat përballet D&F dhe efektin e tyre në planifikimin dhe kryerjen pasuese të auditimit. **(16 pikë)**
- (c) Rekomandoni procedurat e duhura për komunikimin me menaxhmentin e lartë dhe me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me dobësitë e kontrollit të identifikuar. **(7 pikë)**

(Gjithsej: 35 pikë)

Zgjidhja

Kjo është hera e parë që kompani do t'i nënshtrohet auditimit dhe gjithashtu hera e parë që tregton. Kjo do të thotë se auditimi ka gjasë të jetë shumë më kompleks dhe të zgjasë më shumë se auditimet e mëvonshme. Në mënyrë të veçantë, çështjet e mëposhtme do të duhet të adresohen.

1. Krijimi dhe auditimi i një pozicioni fillestar. Ne do të duhet të vendosim pozicionin fillestar në ditën e parë të tregtimit. Kjo do t'i kërkojë auditorit të marrë në konsideratë transaksionet që kanë ndodhur përpara asaj date, për shembull, ngritjen e kapitalit të aksioneve dhe huasë, blerjen e pasurisë joqarkulluese, ndoshta blerjen e disa stoqeve dhe të ngjashme.

2. Audituesit do të duhet gjithashtu të familjarizohen me kushtet ligjore dhe rregullatore të industrisë dhe kornizën specifike ligjore në të cilin operon D&F. Për shembull, audituesit do të duhet të shqyrtojnë tenderin që ka dorëzuar me sukses në mënyrë që t'i fitohet kontrata; vetë kontrata; marrëveshjet e tij me furnitorët dhe stafin e kështu me radhë.

3. Fakti që ky është auditimi i parë do të thotë se audituesit nuk kanë njohuri dhe përvojë kumulative audituese. Kjo e bën të vështirë të dihet paraprakisht, për shembull, sa të mira do të jenë librat dhe të dhënat e kompanisë; sa do të jetë i kooperativ menaxhmenti dhe cilat janë prioritetet e menaxhmentit për sa i përket rezultateve financiare.

4. Procedurat analitike do të jenë shumë më të vështira në vitin e parë. Audituesit duhet ende ta përdorin atë në fazën e planifikimit dhe në fazën përfundimtare të auditimit. Kjo është një kërkesë e SNA 520. Natyrisht, ne nuk do të kemi shifra korresponduese ose krahasuese për t'u përdorur si pikë referimi. Krahasimi me buxhetet mund të jetë i mundur, por gjithashtu mund të jetë mjaft i pasigurt. Ky lloj biznesi mund të mos ketë mesatare të përcaktuara mirë të industrisë me të cilat mund të krahasohet.

5. Sistemet dhe kontrollet do të duhet të dokumentohen nga e para, ose nëse dokumenti tashmë nga menaxhmenti ose auditimi i brendshëm do të duhet të verifikohet përmes vëzhgimit dhe, nëse planifikojmë të mbështetemi në sistemet për evidencën e auditimit, teste të gjera të kontrolleve do të duhet të kryhen.

6. Së fundi, fakti që pasqyrat financiare mbulojnë pak më shumë se një vit, në vetvete nuk krijojnë probleme auditimi edhe pse mund të ketë komplikime të tjera, si p.sh. të bëjë më komplekse llogaritjet e tatimit të korporatës.

(b) Rreziqet e biznesit 'rezultojnë nga kushte, ngjarje, rrethana ose veprime të rëndësishme që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e entitetit për të arritur objektivat e saj dhe për të zbatuar strategjitë e saj, ose nëpërmjet vendosjes së objektivave dhe strategjive të papërshtatshme'. Rreziqet e biznesit mund të klasifikohen në çdo numër mënyrash, por një mënyrë popullore për të analizuar rrezikun e biznesit, është marrja në konsideratë e rrezikut operacional, rrezikut financiar dhe rrezikut të pajtueshmërisë. Rreziqet mund të mbivendosen dhe ndërveprojnë, kështu që kjo është në të vërtetë vetëm një pikënisje për shqyrtimin e rrezikut. D&F mund të thuhet se vuan nga rreziqet e mëposhtme:

Operacionale

1. Skenari thotë se kemi monopol në biznes për këto vite për shkak të një marrëveshjeje licencimi. Ekziston qartë rreziku që licenca të mos rinovohet pas tre vjetësh, ose monopoli të mos vazhdojë. Çdo sugjerim se kjo është një mundësi serioze mund të destabilizojë biznesin për sa i

përket kontratave me furnitorët, qarkullimit të stafit, mbledhjes së borxheve dhe shumë faktorëve të tjerë. Efektet e kësaj mund të ndiheshin edhe në vitin e dytë të tregtimit.

2. Shqetësimi politik dhe i komunitetit në dhënien e kontratave (dhe angazhimi ynë) në dokumentet e tenderit na e bëjnë të vështirë marrjen e vendimeve thjesht komerciale. Nëse ne perceptohemi se po veprojmë në mënyrë të padrejtë, kjo si rrezik mund të çojë në presion politik për të mos rinovuar kontratën tonë apo edhe për ta anuluar atë.

3. Vetë biznesi është i ri dhe është e paqartë se sa i vendosur është modeli i biznesit që ne po përdorim. Ekziston rreziku që planet tona të biznesit të jenë, në një farë mënyre, të paqëndrueshme, ndoshta sepse vlerësimet e kostos ishin tepër optimiste ose vëllimi i materialeve që mbledhim nuk arrin të arrijë objektivat e planifikuar. Për momentin, ne kemi një monopol për sa i përket shërbimit që ofrojmë, por kjo nuk do të thotë që disa klientë potencialë nuk do të gjejnë mënyra të tjera (madje edhe mënyra të paligjshme) për të hedhur mbeturinat e tyre.

4. Modeli ynë i biznesit duket se mbështetet në të paktën disa subvencione nga qeveria për ta bërë atë të realizueshme. Ekziston rreziku që kjo të shkurtohet, të kufizohet, të eliminohet ose të bëhet më kufizuese në të ardhmen.

5. Biznesi mbështetet shumë tek ofruesit e tjerë të specializuar si ata që operojnë vendgrumbullimet, objektet e riciklimit dhe inceneratorët. Me sa duket ka relativisht pak ofrues të tillë që u jep atyre një levë të konsiderueshme mbi D&F. Ekziston rreziku i pasojave negative për D&F nëse do të kishte ndonjë mosmarrëveshje me ofrues të tillë, ose për shembull, nëse disa nga këta ofrues shërbimesh dalin jashtë veprimtarisë.

Financiare

1. Skenari nënkupton që kompania është tashmë nën presion financiar dhe ka pësuar tarifa të rënda interesi gjatë vitit të parë.

2. Ai gjithashtu sugjeron që sistemet e kontrollit janë të pamjaftueshme dhe përderisa ky është më shumë një rrezik auditimi (rrezik kontrolli) sesa një rrezik biznesi, ai rrit rrezikun që kompania të futet në vështirësi financiare, për shembull, duke e bërë më të vështirë të mbledhë borxhet ose të ndërpresë ofrimin e shërbimit për pagesit e ngadalshëm. Çdo vonesë e mundshme në marrjen e pagesave të subvencionit shërben vetëm për të rritur rrezikun.

3. Duke qenë se kompania është e sapokrijuar, ekziston një rrezik në rritje që do ta ketë të vështirë të mbledhë financa shtesë nëse është e nevojshme. Kjo mund të mos ndihmohet nga opozita politike dhe e komunitetit.

Pajtueshmëria

1. Të gjitha bizneset rrezikojnë të mos respektojnë një sërë legjislacioneve dhe rregulloresh si standardet e tregtisë dhe reklamave, ligji i punës, rregulloret e shëndetit dhe sigurisë, ndotja akustike, emetimet e mjedisit, ligji tatimor, ligji dhe rregulloret e praktikës së sekretarisë së kompanive dhe disa më shumë.

2. Rregulloret që paraqesin rrezikun më të madh për këtë lloj biznesi janë rregulloret mjedisore si ato që kanë të bëjnë me grumbullimin, ruajtjen dhe asgjësimin e mbetjeve; rregulloret e shëndetit dhe sigurisë si ato që përfshijnë automjete, kamionë dhe pajisje për kondensim të mbeturinave; dhe rregulloret e punësimit. Mospërputhja mund të rezultojë në gjoba, ose përfundimisht humbje të licencës për të vepruar. Pothuajse të gjitha rreziqet e mësipërme do të sugjeronin që, ndërkohë që kjo kompani mund të mos duket se është në rrezik të menjëhershëm për të mos

qenë në gjendje të vazhdojë tregtimin, megjithatë, ekziston nevoja për një konsideratë të gjerë të "vazhdimësisë" si pjesë e procesit të auditimit. Ne kemi nevojë, për shembull, të

- Konsiderojmë me kujdes gjendjen aktuale financiare
- Rishikojmë parashikimet e rrjedhës së parasë
- Qasemi me kujdes se si kompania planifikon të kapërcejë çdo mungesë financimi
- Vlerësojmë në mënyrë kritike vlerësimin e drejtorëve për rreziqet që kontrata jonë nuk do të rinovohet në përvjetorin e tretë të dhënies së saj.
- Qasemi në mjedisin politik në lidhje me rrezikun për vazhdimin e pagesave të subvencionit.

3. Rreziqet e pajtueshmërisë mund të manifestohen në detyrimin e D&F për të paguar gjoba apo edhe humbjen e licencës për të vepruar. Kjo mbulohet nga SNA 250. Ne duhet të sigurojmë veten se ky rrezik është në një nivel mjaft të ulët duke ekzaminuar sistemet e D&F në këtë drejtim dhe duke konfirmuar se nuk ka pretendime apo akuza të pazgjidhura kundër D&F në këtë pikë. Ne do të na duhet konfirmimi nga këshilltarët ligjorë të kompanisë për këtë pikë dhe do të na duhet gjithashtu të shqyrtojmë me kujdes procesverbalet e bordit dhe ngjarjet pas përfundimit të periudhës.

(c) SNA 265 merret me komunikimin e mangësive në kontrollin e brendshëm tek personat e ngarkuar me qeverisje. Ne jemi të detyruar sipas këtij standardi t'i komunikojmë menaxhmentit dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dobësitë e rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Në këtë rast, ne kemi identifikuar disa dobësi të rëndësishme veçanërisht në fushën e të hyrave. Ne i kemi diskutuar këto tashmë me menaxherët e divizionit, në mënyrë që të jemi mjaft të sigurt se ka dobësi aktuale dhe se, për shembull, nuk ka kontrolle kompensuese. Ky në vetvete është një hap i parë i rëndësishëm. Hapi tjetër duhet të jetë komunikimi i shqetësimeve tona gojarisht dhe në mënyrë konstruktive tek menaxhmenti i lartë dhe tek TCËG sa më shpejt të jetë e mundur. Ne duhet t'u paraqesim atyre dobësitë që kemi zbuluar; pasojat që lindin për sa i përket rreziqeve për biznesin dhe gjithashtu për sa i përket pasojave për raportin e auditimit dhe, në këtë rast, për çdo raport sigurie që mund të na duhet të bëjmë në të ardhmen. Ne nuk duhet të shtyhemi ta bëjmë këtë nga ndjenja se menaxhmenti mund të mos veprojë sipas asaj që po themi. Nëse ata zgjedhin të mos veprojnë, kjo mund të ketë pasoja për ta, por ne duhet t'i parashtrijmë ato pasoja qartë për ta. Natyrisht, ne duhet të diskutojmë me ta edhe rekomandimet tona për të korrigjuar dobësitë. Hapi tjetër është të komunikojmë zyrtarisht shqetësimet tona me shkrim në një Letër të Dobësive të Kontrollit (ose Letër Menaxhmenti) ose ndonjë dokument të tillë. Kjo duhet të përcaktojë detajet e përmendura më lart në një mënyrë koncize dhe konstruktive dhe të ftojë një përgjigje nga menaxhmenti për të na informuar kur ata kanë zbatuar kontrollet ose arsyetimin e tyre për të mos e bërë këtë.

Detyra 2

Muni SHA është një nga ofruesit kryesorë në botë të udhëtimeve turistike, që operon nën disa emra markash për të shitur paketa pushimesh. Kompania kujdeset për më shumë se 10 milionë klientë në 12 muajt e fundit. Pasqyrat financiare draft për vitin e mbyllur më 30 shtator 2021 tregojnë të ardhura prej 3,200 milion Euro, fitim para tatimit prej 150 milion Euro dhe pasuri totale prej 4,100 milionë Euro. Drejtuesit e Muni ShA fitojnë një bonus bazuar në fitimin para tatimit të kompanisë.

Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Muni ShA. Auditimi përfundimtar është drejt përfundimit dhe pikat e mëposhtme janë vënë në dukje nga i seniori i auditimit për vëmendjen tuaj:

Në korrik 2021, mijëra pushues mbetën të bllokuar jashtë vendit pasi kompania që operonte linjën kryesore ajrore nga Muni ShA shkoi në likuidim. Pushuesit u detyruan të prisnin mesatarisht dy javë përpara se të ktheheshin në shtëpi duke përdorur një linjë ajrore alternative. Ata kanë formuar një grup i cili kërkon dëmshpërblim për kohën që u detyruan të kalonin jashtë vendit, me shumën totale të 20 milionë Euro. Zërat për të cilët grupi kërkon kompensim përfshijnë kostot e akomodimit dhe të jetesës, të ardhurat e humbura dhe shqetësimin e shkaktuar nga situata. Kërkesa nuk është njohur ose shpalosur në draft pasqyrat financiare, pasi menaxhmenti argumenton se shumata e plotë e pagueshme do të mbulohej nga sigurimi i Muni ShA.

Një pjesë e aktiviteteve të kompanisë, që operon nën markën Seli Kruz, ofron pushime në lundrim. Për shkak të recesionit ekonomik, të ardhurat e segmentit të biznesit të Seli Kruz kanë rënë me 25% këtë vit, dhe fitimi para tatimit ka rënë me 35%. Seli Kruz kontribuoi me 640 milionë Euro në të hyrat totale në vitin deri më 30 shtator 2021 dhe ka pasuri të identifikueshme prej 235 milionë Euro, duke përfshirë disa anije të mëdha lundrimi. Marka Seli Kruz nuk njihet në pasqyra si një pasuri e patrupëzuar, pasi është krijuar nga brenda.

Më 15 nëntor 2021, Muni ShA bleu Leli ShA, një kompani që ofron pushime aventureske për udhëtarët e pavarur. Leli ShA përfaqëson një blerje të rëndësishme, por kjo nuk është përmendur në pasqyrat financiare.

Kërkohet:

Komentoni çështjet që duhet të merrni parasysh dhe përshkruani dëshmitë e auditimit që duhet të prisni të gjeni në rishikimin tuaj të dokumenteve të punës së auditimit për vitin e mbyllur në shtator 2021 në lidhje me:

- (a) Pretendimet për kompensim, (8 pikë)
- (b) Seli Kruz, dhe (7 pikë)
- (c) Blerjen e Leli ShA (5 pikë)

(Gjithsej: 20 pikë)

Zgjidhja

a) Kërkesa për kompensim Çështje për t'u marrë parasysh

Kërkesa për kompensim është materiale për fitim pasi përfaqëson 13.3% të fitimit para tatimit (20/150 x 100%). Ajo nuk është materiale për pasqyrën e pozicionit financiar pasi përfaqëson vetëm 0.49% të totalit të pasurive (20/4,100 x 100%).

Menaxhmenti mund të dëshirojë të injorohet provizionin, pasi njohja e tij do të reduktonte fitimin para tatimit me një shumë materiale, duke reduktuar kështu pagesën e bonusit të tyre. Kjo çështje është gjithashtu në thelb e rrezikshme pasi bazohet në arritjen e një gjykimi në lidhje me probabilitetin që shumata të bëhet e pagueshme.

Megjithatë pretendimi nuk mund të injorohet. Duhet të bëhet një vlerësim i duhur nëse shumata e kërkuar duhet të trajtohet si provizion apo si detyrim kontingjent. Sipas SNK 37 *Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente*, një provizion duhet të njihet kur ekziston një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, një transfer i mundshëm i përfitimit ekonomik dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës. Në rast se ka një transfer të mundshëm të përfitimit ekonomik, duhet të shpalsoset në pasqyrat financiare që përshkruan natyrën dhe efektin e mundshëm financiar të vlerësuar të detyrimit kontingjent.

Fakti që kompensimi, nëse paguhet, do të mbulohej nga sigurimi, nuk do të thotë se çështja duhet të shpërfillet. Çdo shumë potencialisht e rikuperueshme nga siguresit duhet të vlerësohet nëse është praktikisht e sigurt që do të merret, në të cilin rast duhet të njihet një llogari e arkëtueshme, ose nëse rikuperueshmëria është më pak se praktikisht e sigurt, një shënim në pasqyrat financiare që përshkruan pasurinë kontingjente duhet të shpalojë. Duhet të bëhet një vlerësim mbi rikuperueshmërinë e shumës së kërkuar.

Detyrime të mëtejshme mund të duhet gjithashtu të njihen në lidhje me kostot ligjore. Kjo do të reduktonte më tej fitimin në fund të vitit.

Në rast se pretendimi rezulton në njohjen e një provizioni dhe rimbursimi i sigurimit rezulton në njohjen e një llogarie të arkëtueshme, të dy zërat duhet të paraqiten veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar, dhe jo të kompensohen.

Dëshmitë

- Një kopje e pretendimit të bërë nga grupi i pushuesve, duke detajuar 20 milionë eurot e kërkuar dhe bazën e pretendimit.
- Një rishikim i korrespondencës midis 'grupit të pretendimeve' dhe kompanisë.
- Korrespondencë nga përfaqësuesit ligjorë të kompanisë, duke treguar mendimin e tyre për rezultatin më të mundshëm të pretendimit.
- Një kopje e çdo njoftimi për shtyp të bërë nga kompania në lidhje me pushuesit e bllokuar - kjo mund të ndihmojë për të përcaktuar nëse ekziston një detyrim konstruktiv.
- Një rishikim i mbulimit të shtypit dhe artikujve në internet për situatën, për të vlerësuar çdo koment të bërë publikisht nga përfaqësuesit e kompanisë në lidhje me pretendimin.
- Një rishikim i kushteve standarde që pushuesit bien dakord për rezervimin e pushimeve – kjo mund të ndihmojë në përcaktimin e çdo detyrimi ligjor, p.sh. për të mbuluar koston e akomodimit përpara se të ktheheni në shtëpi.
- Detajet e çdo linje ndihme ose mjeti tjetër me të cilin pushuesit e bllokuar iu dhanë këshilla në kohën e incidentit (p.sh. nëse kompania i këshilloi ata të rezervonin akomodim alternativ, kjo mund të nënkuptojë se kompania është përgjegjëse për koston).
- Një rishikim i faturave të marra para dhe pas fundit të vitit në lidhje me kostot ligjore, për t'u siguruar që janë përfshirë në mënyrë adekuate në shpenzime dhe të përlllogaritura nëse është e nevojshme.

- Një kopje e kontratës së sigurimit të biznesit që përshkruan nivelin e mbulimit, nëse ka, të parashikuar për këtë situatë, dhe çdo shumë që nuk do të mbulohet (një tejkallim i policës).
- Korrespondencë midis kompanisë së sigurimeve dhe klientit tonë që përcakton nëse është bërë një pretendim për sigurimin.
- Një përfaqësim me shkrim i menaxhmentit që tregon opinionin e menaxhmentit për rezultatin e çështjes gjyqësore dhe gjasat e rimbursimit nga mbulimi i sigurimit.

(b) Seli Kruz

Çështje për t'u marrë parasysh

Operacioni i Seli Kruz është padyshim një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Muni, duke kontribuar 20% në të hyrat ($640/3,200 \times 100\%$). Kjo rrjedhë e të hyrave është e rëndësishme për pasqyrat financiare. Pasuritë e identifikueshme të segmentit të biznesit përfaqësojnë 5,7% të totalit të pasurive ($235/4,100 \times 100\%$), pra ato janë materiale për pasqyrën e pozicionit financiar.

Fakti që marka ka performuar keq është një tregues i zhvlerësimit (dëmtimit) sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. Edhe pse vetë marka nuk njihet, pasuritë e identifikueshme me markën duhet të vlerësohen për dëmtim nga menaxhmenti, për të përcaktuar shumën e tyre të rikuperueshme.

Pasuritë përfaqësojnë një njësi gjeneruese të mjeteve monetare, pasi rrejdhat e paraasë të gjeneruara nga pasuritë e identifikueshme me Seli Kruz janë të pavarura nga rrjedhat e parase të krijuara nga pasuritë tjera të kompanisë. Menaxhmenti duhet të kryejë një test dëmtimi duke llogaritur vlerën në përdorim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, dhe gjithashtu të llogarisë vlerën e drejtë minus koston e shitjes, për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të pasurive së bashku. Çdo humbje nga dëmtimi duhet të shpenzohet. Menaxhmenti do të dëshirojë të shmangë njohjen e një humbjeje nga dëmtimi në pasqyrën e të ardhurave për shkak të ndikimit të dëmshëm në pagesën e bonusit të tyre.

Llogaritjet e përfshira në testin e dëmtimit përmbajnë elemente subjektive, të tilla si përcaktimi i normës së duhur të skontimit për skontimin e rrjedhave të parase në vlerën aktuale, dhe supozimet mbi rrjedhat e parashikuara të parase për markën. Supozimet e menaxhmentit mund të kenë nevojë të trajtohen me skepticism për shkak të bonusit të bazuar në fitim.

Dëshmi

- Një rishikim i testit të dëmtimit nga menaxhmenti (nëse kryhet), duke përfshirë:
- vlerësimi se është përdorur një normë e përshtatshme skontimi
 - marrëveshje që supozimet për të përcaktuar rrjedhat e ardhshme të parase janë të arsyeshme dhe në përputhje me të kuptuarit e biznesit
 - marrëveshje që vlera kontabël e saktë e pasurive është përdorur për krahasimin e vlerës së rikuperueshme
 - marrëveshje që të gjitha pasuritë e identifikueshme janë përfshirë në njësinë gjeneruese të rrjedhës së parase
 - rillogaritja e të gjitha shifrave.
- Diskutim me menaxhmentin mbi performancën e pritshme të ardhshme të Seli Kruz, duke përfshirë çdo strategji që do të vendoset për të luftuar performancën në rënie.
- Një rishikim i pasqyrave financiare menaheriale për performancën e Seli Kruz pas datës së raportimit.
- Një rishikim i nivelit të rezervimeve të bëra paraprakisht për lundrimet që do të kryhen në të ardhmen.

(c) Leli

Çështjet

Sipas SNK 10 *Ngjarjet pas Periudhës Raportuese*, blerja e një filiali pas fundit të vitit është një ngjarje jo korigjuuese, pasi nuk lidhet me një gjendje ekzistuese në fund të vitit. Nëse ngjarjet jokorigjuuese pas datës së raportimit janë materiale, mos-shpalosja e këtyre informatave në pasqyrat financiare mund të ndikojë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të pasqyrave financiare. Një shënim në pasqyrat financiare duhet të japë informacion shpjegues për secilën kategori materiale të ngjarjeve jokorigjuuese, natyrën e ngjarjes dhe një vlerësim të efektit financiar të saj, ose një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.

Meqenëse një shënim nuk është dhënë dhe Leli përfaqëson një blerje të rëndësishme, aktualisht ka një shkelje të kërkesave për shpalosje sipas SNK 10. Nëse një shënim nuk jepet, opinioni i auditimit duhet të kualifikohet 'përveç për' për shkak të anomalive materiale të shkaktuar nga mungesa e dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara nga standardet e kontabilitetit.

Dëshmitë:

- Një kopje e njoftimit për shtyp që njofton blerjen, duke përfshirë datën e shpalljes.
- Një kopje e çdo marrëveshjeje ligjore që ka të bëjë me blerjen, duke përfshirë datën që kontrolli i kalon Muni.
- Një rishikim i çdo raporti të kujdesit të duhur të marrë në lidhje me blerjen, duke detajuar vlerën e pasurive të blera dhe shumën e paguar.
- Një rishikim i pasqyrave financiare të Leli, për të përcaktuar se ajo përfaqëson një blerje të rëndësishme për grupin, prandaj garanton një shënim shpjegues.
- Një rishikim i çdo shënimi të dhënë nga menaxhmenti për t'u përfshirë në pasqyrat financiare

Detyra 3

(a) Buti ShA është një klient i ri auditimi i firmës suaj. Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 maj 2021. Buti ShA projekton dhe prodhon motorë avionësh dhe pjesë këmbimi, dhe është një filial i një grupi shumëkombësh. Ekstraktet nga draft pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozitës financiare

	31 maj 2021 Draft milion euro	31 maj 2020 Aktual milion euro
Pasuritë		
Pasuritë joqarkulluese		
Pasuritë e patrupëzuara (Shënimi 1)	200	180
Prona , bashkë dhe impiantet (Shënimi 2)	1,300	1,200
Pasuri e tatimit të shtyrë (Shënimi 3)	235	20
Pasuri financiare	25	35
	1,760	1,435
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	1,300	800
Të arkëtueshmet	2,100	1,860
	3,400	2,660
Gjithsej pasuritë	5,160	4,095
Ekuiteti dhe të caktuar		
Eqkuiteti		
Kapitali aksionar	300	300
Fitimet e mbajtura	(525)	95
	(225)	395
Detyrimet afatgjata		
Kredi afatgjata (Shënimi 4)	1,900	1,350
Provizionet (Shënimi 5)	185	150
	2,085	1,500
Detyrimet afatshkurta		
Kredia afatshkurtë	800	400
Të pagueshmet	2,500	1,800
	3,300	2,200
Gjithsej ekuititeti dhe të caktuar	5,160	4,095

Shënimet e pasqyrës së pozicionit financiar:

Shënimi 1: Pasuritë e patrupëzuara përfshijnë zërin e mirë për blerjen e filialeve (80 milionë Euro) dhe kostot e zhvillimit të kapitalizuara në projektet e zhvillimit të motorit (120 milionë Euro).

Shënimi 2: Prona, objektet dhe pajisjet përfshijnë tokën dhe ndërtesat me vlerë 25 milionë Euro, mbi të cilat ekziston një ngarkesë fikse.

Shënim 3: Pasuria e tatimit të shtyrë ka lindur pas disa vitesh me humbje nga kompania.

Pasuria përfaqëson përfitimin tatimor të humbjeve tatimore të pashfrytëzuara të bartura.

Shënimi 4: Huamarrjet afatgjata përfshijnë një bono për t'u shlyer në korrik 2022 dhe një hua nga kompania mëmë e Buti ShA për t'u shlyer në dhjetor 2022.

Shënimi 5: Provizionet kanë të bëjnë me garancitë e ofruara për klientët.

Shënim 6: Huamarrjet afatshkurtra përfshijnë një mbitërheqje (25 milionë Euro), një hua afatshkurtër (60 milionë Euro) për t'u shlyer në gusht 2021 dhe një hua bankare (715 milionë Euro) e ripagueshme në shtator 2021.

Ju keni marrë një email nga partneri i auditimit përgjegjës për auditimin e Buti ShA:

Përsëndetje

E kuptoj që puna e auditimit në Buti ShA fillon këtë javë. Unë jam i shqetësuar për të ardhmen e kompanisë, pasi që si rrjedhojë e recesionit ekonomik, shitjet kanë pasur rënie, disa kontrata të rëndësishme të klientëve janë anuluar papritur dhe konkurrenca nga jashtë ka dëmtuar pjesën e tregut që kishte më parë Buti ShA.

- a) Ju lutemi, përgatisni një dokument/memo, për përdorimin tim, në të cilat identifikoni dhe shpjegoni çdo çështje që lind nga rishikimi juaj i draft-pasqyrës së pozicionit financiar dhe parashikimit të rrjedhës së parasë, të cilat mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar si vijimësi. Parashikimi i rrjedhës së parasë sapo më është dërguar nga klienti dhe është bashkangjitur. Ai mbulon vetëm tre muajt e parë të vitit të ardhshëm financiar, klienti aktualisht është duke përgatitur parashikimet për të gjithë periudhën 12 mujore. Ju lutemi jini skeptik kur rishikoni parashikimin, pasi supozimet mund të jenë optimiste. **(10 pikë)**
- b) Gjithashtu, ju lutemi rekomandoni procedurat kryesore të auditimit që duhet të kryhen në parashikimin e rrjedhës së parasë. Rekomandimet tuaja mund të përfshihen në një seksion të veçantë të memos. **(8 pikë)**

Faleminderit

Shtojcë: Parashikimi i rrjedhës së parasë për tre muajt deri më 31 gusht 2021

	Qershor-21 milion euro	Korrik-21 milion euro	Gusht-21 milion euro
Arkëtimet me para			
Arkëtimet nga konsumatorët (shënimi 1)	175	195	220
Arkëtimet nga kredia (shënimi 2)		150	
Subvencioni qeveritar (shënimi 3)			50
Shitja e pasurive financiare	50		
Total	225	345	270
Pagesat me para			
Pagesat operative	200	200	290
Pagesa e interesit	40	40	40
Kthimi i kredisë			60
Total	240	240	390
Rrjedha neto e parasë për muajin	(15)	105	(120)
Saldo fillestare e parasë	(25)	(40)	65
Saldo përfundimtare e parasë	(40)	65	(55)

Shënime për parashikimin e rrjedhës së parasë:

Ky parashikim i rrjedhës së parasë është përgatitur nga menaxhmenti i Buti ShA dhe bazohet në supozimet e mëposhtme:

1. Arkëtimet në para nga klientët duhet të përshpejtohen duke pasur parasysh përmirësimin e parashikuar të kushteve ekonomike. Gjithashtu, kompania ka angazhuar burime shtesë për funksionin e kontrollit të kredisë, për të përshpejtuar arkëtimin e borxheve të vonuara.
2. Huaja pritët të pranohet në korrik 2021 dhe është aktualisht duke u negociuar nga kompania mëmë Rubi ShA.
3. Subvencionimi i qeverisë do të merret pasi aplikimi ynë të jetë miratuar. Subvencioni u jepet kompanive që operojnë në zona me papunësi të lartë dhe subvencionon pagat dhe mëditjet e paguara për stafin.

Kërkohet:

Përgjigjuni emailit nga partneri i auditimit. **(18 pikë)**

Shënim: Ndarja e pikëve është paraqitur në emailin e partnerit

(b) Duke pasur parasysh informacionin e dhënë në lidhje me Buti ShA, ka gjasë që auditori të mund të konkludojë në përfundimin e të gjitha procedurave të nevojshme të auditimit, se përdorimi i supozimit të vijimësisë në pasqyrat financiare është i përshtatshëm, por që një pasiguri materiale, ose disa pasiguri material ekzistojnë në lidhje me aftësinë e kompanisë për të vazhduar si vijimësi.

Kërkohet:

Nëse procedurat e auditimit tregojnë se ekzistojnë një ose më shumë pasiguri materiale në lidhje me aftësinë e Buti ShA për të vazhduar si vijimësi:

Shpjegoni çështjet që duhet të merren parasysh në formimin e opinionit të auditimit dhe ndikimet e mundshme në raportin e auditorit. **(7 pikë)**

(Gjithsej: 25 pikë)

(a) Memo

Re: Vlerësimi fillestar i vijimësisë - Buti ShA

Hyrje

Buti SHA përballet me rrezik të konsiderueshëm biznesi për shkak të rënies së shitjeve dhe humbjes së klientëve dhe pjesës së tregut. Këto shënime informuese përmbajnë një vlerësim fillestar të vijimësisë, bazuar në draft-pasqyrën e pozicionit financiar, dhe një parashikim të rrjedhës së parasë të përgatitur për tre muajt e parë të vitit të ardhshëm financiar. Procedurat e auditimit do të rekomandohen gjithashtu për parashikimin e rrjedhës së parasë.

(i) Vlerësimi i draft pasqyrës së pozicionit financiar.

Çështja më e dukshme është se Buti aktualisht nuk ka një bilanc pozitiv në para. Pasqyra e pozicionit financiar përfshin një mbitërheqje prej 25 milionë Euro. Kjo mungesë e parave të gatshme do ta bëjë të vështirë për kompaninë që të menaxhojë ciklin e saj operativ dhe të bëjë pagesat e nevojshme të interesit, përveç rasteve kur disponohen para të tjera.

Buti është në një pozicion të detyrimeve neto, siç tregohet nga shifra negative e fondeve të aksionerëve. Shifra e fitimeve të pashpërndara të kompanisë tani është negative. Detyrimet neto dhe humbjet e rëndësishme janë të dy shembuj të kushteve financiare të listuara në SNA 570 *Hipoteza e vijimësisë*, të cilat mund të hedhin dyshime në lidhje me supozimin e vijimësisë.

Shënimi 3 tregon se Buti ka qenë me humbje për disa vite. Humbjet e përsëritura janë një tregues i mëtejshëm i problemeve me vijimësinë. Pak kompani mund të mbajnë shumë periudha të njëpasnjëshme me humbje.

Ka disa zëra që njihen, të cilët nëse rregullohen do të përkeqësojnë pozicionin e detyrimeve neto. Për shembull, një pasuri tatimore e shtyrë njihet në 235 milionë Euro. Kjo pasuri duhet të njihet vetëm nëse Buti mund të demonstrojë se fitimet e ardhshme do të jenë të mjaftueshme për të mundësuar rikuperimin e pasurisë. Duke qenë se Buti ka qenë me humbje prej disa vitesh, është e diskutueshme që kjo pasuri të mos njihet fare. Për më tepër, njihet një pasuri e patrupëzuar që lidhet me kostot e zhvillimit prej 120 milionë Euro. Një nga kriteret për kapitalizimin e kostove të tilla është që të ekzistojnë burime adekuate për përfundimin e zhvillimit. Duke pasur parasysh mungesën e parave të Buti, ky kriter mund të mos jetë më i zbatueshëm. Nëse do të bëheshin rregullime për të fshirë këto pasuri, detyrimet neto do të bëheshin 580 milionë Euro.

Shënimi 2 tregon se tarifat fikse ekzistojnë mbi asetet me vlerë 25 milionë Euro. Nëse Buti dështon t'i bëjë pagesat kreditorit që mban ngarkimin mbi asetet, asetet mund të konfiskohen, duke ndërprerë operacionet e Buti.

Ka hua të konsiderueshme afatshkurtëra për t'u shlyer - veçanërisht një hua bankare prej 715 milionë Euro për t'u shlyer në shtator 2021. Është e vështirë të shihet se si Buti do të jetë në gjendje ta shlyejë këtë kredi duke pasur parasysh mungesën aktuale të parave të gatshme. Parashikimi i rrjedhës së parasë nuk tregon se ka gjasa të krijohen para të mjaftueshme pas fundit të vitit për të mundësuar ripagimin e kësaj kredie.

Provizionet janë klasifikuar si detyrime afatgjata. Duke qenë se provizionet kanë të bëjnë me garancitë e klientëve, ka të ngjarë që disa nga tepricat e provizioneve të klasifikohen si një detyrim afatshkurt. Ky prezantim i pasaktë i mundshëm ndikon në vlerësimin e likuiditetit, pasi klasifikimi i gabuar do të ndikojë në rrjedhën e parasë që kërkohet për të përmbushur detyrimin e garancive.

Pozicioni i dobët financiar i Buti do të thotë se nuk ka gjasa të jetë në gjendje të mbledhë financim nga një palë e tretë.

Vlerësimi i parashikimit të rrjedhës së parasë

Nga një këndvështrim i përgjithshëm, parashikimi i rrjedhës së parasë tregon se deri në fund të gushtit, Buti do të jetë ende në një pozicion negativ të parasë. Siç u diskutua më lart, kjo është veçanërisht shqetësuese duke qenë se një kredi prej 715 milionë Euro duhet të shlyhet në shtator.

Supozimi në lidhje me arkëtimet e parave të gatshme nga klientët duket optimist. Është shumë e thjeshtë të supozohet se rimëkëmbja e parashikuar ekonomike do të çojë në një përmirësim të papritur në mbledhjen e parave nga klientët, edhe nëse burime shtesë përdoren për kontrollin e kredisë.

200 milionë Euro nga arkëtimet e parave të gatshme për këtë periudhë tre mujore kanë të bëjnë me kreditë dhe subvencionet të cilat aktualisht janë duke u negociuar dhe aplikuar. Këto arkëtime monetare nuk janë të garantuara dhe nëse nuk merren, pozicioni i përgjithshëm i parasë në fund të periudhës do të jetë shumë më i keq se sa është parashikuar aktualisht. Arkëtimet e parasë për qershor 2021 përfshijnë të ardhurat nga një shitje e pasurive financiare prej 50 milionë Euro. Është e diskutueshme nëse kjo shumë parash do të gjenerohet, duke qenë se pasuritë financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 25 milionë Euro. Vlera e supozuar e shitjes prej 50 milionë euro mund të jetë tepër optimiste.

Si përfundim, parashikimi i rrjedhës së parasë mund të mos jetë i besueshëm, pasi supozimet janë optimiste dhe financimi shtesë nuk është i garantuar. Kjo do të thotë se tre muaj në vitin e ardhshëm financiar, pozicioni i parasë së gatshme i kompanisë ka gjasë të jetë përkeqësuar dhe huatë dhe detyrimet tregtare të cilat duhet të paguhet ka gjasë të mbeten të papaguara. Kjo hedh dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e Buti për të vazhduar operimin në vijimësi.

(ii) Procedurat e rekomanduara të auditimit:

- Diskutoni me menaxhmentin arsyet për të supozuar se mbledhja e parave të gatshme nga klientët do të përmirësohet për shkak të 'përmirësimit të pritshëm të kushteve ekonomike'. Merrni parasysh vlefshmërinë e arsyeve në përputhje me të kuptuarit e biznesit.
- Kërkoni për natyrën e burimeve shtesë që do t'i kushtohen funksionit të kontrollit të kredisë, p.sh. detajet e stafit shtesë të rekrutuar.
- Për marrjen e kredisë, inspektoni dokumentacionin me shkrim në lidhje me kërkesën për financim nga kompania mëmë. Kërkoni konfirmim me shkrim nga Rubi në lidhje me shumën e financimit dhe datën që do të merret, si dhe çdo kusht.
- Merrni dhe rishikoni pasqyrat financiare të Rubi, për të shqyrtuar nëse ka burime të mjaftueshme për të siguruar shumën e kredisë së kërkuar.
- Për subvencionin, inspektoni aplikacionin e bërë pranë organit dhënies së subvencionit dhe konfirmoni shumën e subvencionit.
- Lexoni çdo korrespondencë midis Buti dhe organit të dhënies së subvencioneve, veçanërisht duke kërkuar konfirmimin se subvencioni do të jepet.
- Lidhur me shpenzimet operative, verifikoni duke përdorur llogaritë e menaxhimit të muajve të mëparshëm, që daljet e parave operative janë afërsisht 200 milionë Euro në muaj.
- Pyetni për arsyen e rritjes së daljeve të parasë operative në gusht 2021.
- Verifikoni, duke përdorur pasqyrat e menaxhmentit të muajve të mëparshëm, që pagesat e interesit prej 40 milionë Euro në muaj duken të arsyeshme.
- Konfirmoni, duke përdorur marrëveshjen e kredisë, shumën e huasë që do të shlyhet në gusht 2021.
- Pyetni nëse ndonjë pagesë tatimore duhet të paguhet në periudhën tre mujore, si p.sh. tatimi mbi shitjet.
- Bini dakord për pozicionin e hapjes së parave të gatshme në librin e parave të gatshme dhe pasqyrën bankare/barazimin bankar, dhe jepni parashikimin e rrjedhës së parasë.

- Sigurohuni që të merret një parashikim i rrjedhës së parasë për vitin e plotë financiar pasi parashikimi tre mujor është i pamjaftueshëm për qëllimet e auditimit.

Përfundim

Rishikimi i draft pasqyrës së pozicionit financiar dhe parashikimit të rrjedhës së parasë tregon se ka shumë faktorë që tregojnë se Buti po përjeton probleme me vijimësinë. Në veçanti, mungesa e mjeteve monetare dhe shumat e konsiderueshme për t'u paguar brenda disa muajve të fundit të vitit hedhin dyshime të konsiderueshme mbi përdorimin e supozimit të vijimësisë në pasqyrat financiare. Kompania ka kërkuar financim nga kompania e saj mëmë, por edhe nëse kjo ndodh, rrjedha e parasë mbetet një problem i rëndësishëm.

(b) Kur përdorimi i supozimit të vijimësisë në pasqyrat financiare është i përshtatshëm, por ekziston një pasiguri materiale, auditori duhet të marrë parasysh nëse është bërë një shpalosje adekuate e situatës në pasqyrat financiare.

SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* kërkon që në këtë situatë, pasiguria materiale duhet të shpaloset në pasqyrat financiare. SNA 570 kërkon që audituesi të përcaktojë nëse pasqyrat financiare përshkruajnë në mënyrë adekuate ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime mbi aftësinë e entitetit për të vazhduar si vijimësi. Në përcaktimin e përshtatshmërisë së këtij informacioni shpjegues, auditori do të konsideronte nëse shpalosja tërheq qartë vëmendjen e lexuesit mbi mundësinë që entiteti mund të mos jetë në gjendje të vazhdojë të realizojë pasuritë e saj dhe të paguajë detyrimet e saj në rrjedhën normale të biznesit.

Kur shumat e detajeve në lidhje me vijimësinë e shpalosur konsiderohet e përshtatshme, pasqyrat financiare janë plotësisht në përputhje me kornizën e raportimit financiar. Prandaj auditori është në gjendje të shprehë një opinion të pamodifikuar (dmth nuk ka anomali materiale dhe nuk ka kufizime në fushëveprim). SNA 570 kërkon që auditori të përfshijë paragrafin 'Pasiguri të materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë' në raportin e auditimit. Paragrafi i Pasigurisë materiale duhet të theksojë se ekziston një pasiguri materiale dhe duhet të përshkruajë pasigurinë, duke përfshirë çdo informacion financiar përkatës, siç është shumat e detyrimeve neto në fund të vitit. Paragrafi duhet të deklarojë qartë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar si vijimësi.

Paragrafi i Pasigurisë materiale për vijimësinë duhet gjithashtu të deklarojë se opinionin e auditimit nuk është i kualifikuar dhe t'i referohet shënimit të pasqyrave financiare ku diskutohet pasiguria materiale.

Në raste jashtëzakonisht të rralla, mund të ketë pasiguri të shumta që janë të rëndësishme për pasqyrat financiare në tërësi. Në këtë rast, auditori mund ta konsiderojë të përshtatshme që të lëshojë një mohim të opinionit në vend që të shtojë një paragraf të pasigurisë materiale në raportin e auditimit. Një mohim lëshohet në këto raste të rralla për shkak të numrit të pasigurive që pamundësojnë auditorin për të formuar një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Në disa raste, auditori mund të arrijë në përfundimin se shpalosja në lidhje me pasigurinë e vijimësisë është e pamjaftueshme. Në këtë rast, auditori konsideron se pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale, pasi ato nuk përmbushin kërkesat e SNK 1 siç u diskutua më sipër. Në varësi të ashpërsisë së pasigurive materiale, auditori duhet të japë ose një opinion të kualifikuar ose një opinion të kundërt.

Në secilin rast, duhet të përfshihet një paragraf, i titulluar ose 'Baza për Opinion të Kualifikuar' ose 'Bazë për Opinion të Kundërt', sipas rastit. Paragrafi duhet të shpjegojë arsyen e anomalisë materiale, dmth të përmbajë një përshkrim të pasigurisë materiale dhe gjithashtu deklaron se pasqyrat financiare nuk e shpalosin pasigurinë.

Detyra 4

Ju jeni auditor i 'ABC-Prona', një ndërmarrje e mesme e specializuar në dhënien me qira dhe shitjen e qendrave të vogla tregtare anash rrugëve kryesore. Gjatë auditimit të vitit aktual, ju keni gjetur korrespondenca në mes të ABC dhe njërin nga klientët e tyre. Korrespondenca tregon se klienti pretendon se ABC i ka dhënë informata çorientuese sepse qendra tregtare e blerë nga ata nuk ka pasur numrin e vizitorëve potencial ashtu siç kishte premtuar ABC. Njëra nga letrat në mënyrë specifike i referohet veprimit ligjor që do të ndërmarr klienti i ABC. Ju keni diskutuar çështjen me menaxhmentin e ABC por nuk keni marr përgjigje të qartë. Si pjesë e procedurave tuaja të auditimit ju keni kërkuar nga menaxhmenti të ju ndihmojë në përgatitjen dhe qarkullimin e një letre ligjore për avokatët e ABC. Përgjigja e menaxhmentit ishte se ata nuk dëshirojnë të shqetësojnë avokatët e tyre me kërkesa të panevojshme dhe për këtë qëllim menaxhmenti do të nënshkruaj letrën e përfaqësimit në të cilën do të përfshihej një paragraf që adreson në mënyrë të mjaftueshme çështjen e padisë. Përveç kësaj, të gjitha detyrimet kontingjente janë shpalosur në tërësi në shënimet e pasqyrave financiare. Në fund, menaxhmenti tha se nuk ka ndonjë kërkesë ligjore të dërgohet një letër e tillë te avokatët.

Kërkohet:

- a. Shpjegoni cilat janë përgjegjësitë e auditorëve lidhur me paditë e mundshme ose ekzistuese të entitetit që auditojnë. **8 pikë**
- b. Adresoni argumentet e menaxhmentit dhe shpjegoni pse janë ose nuk janë të pranueshme. **9 pikë**
- c. Çfarë duhet të bëjë auditori, duke supozuar se nuk ka kufizime ligjore për dërgimin e letrës. **3 pikë**

(Gjithsej: 20 pikë)

Zgjidhja

- a. Pretendimet dhe çështjet gjyqësore

Auditori duhet të dizajnojë dhe kryejë procedura për të identifikuar çështjet gjyqësore dhe pretendimet që përfshijnë entitetin dhe të cilat mund të rrisin rrezikun e anomalive materiale:

- (a) Bisedat me menaxhmentin dhe nëse është e zbatueshme me anëtarët tjerë të entitetit, përfirë avokatët;
- (b) Rishikimi i procesverbalëve të takimeve të bordit të entitetit dhe këshilltarëve ligjor;
- (c) Rishikimi i shpenzimeve ligjore.

Nëse auditori vlerëson rrezikun e anomalive materiale lidhur me çështjet gjyqësore ose pretendimeve që janë identifikuar ose kur procedurat e kryera të auditimit tregojnë se çështje tjera gjyqësore mund të ekzistojnë, auditori do të kërkojë komunikim direkt me këshilltarët ligjor/avokatët e entitetit. Auditori duhet të bëjë këtë përmes letrës së komunikimit me avokatët, e përgatitur nga menaxhmenti dhe e dërguar nga auditorit. Në letër kërkohet që avokatët të komunikojnë direkt me auditorin. Nëse ligji ose rregulloret nuk lejojnë që avokatët të komunikojnë direkt me auditorët, atëherë auditori duhet të kryej procedura alternative.

Komunikimi me këshilltarët e jashtëm ligjor të entitetit

Komunikimi direkt me këshilltarët e jashtëm ligjor të entitetit i ndihmon auditorit në përfundimin e dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse ka pasur çështje gjyqësore materiale që janë të njohura nga menaxhmenti dhe cilat janë vlerësimet lidhur me ndikimin financiar të këtyre çështjeve, përfshirë koston.

Në disa raste, auditori mund të kërkojë komunikim direkt me këshilltarët ligjor përmes letrës zyrtare. Për këtë qëllim, letra e kërkon që këshilltarët të informojnë auditorin për çfardo çështje

gjyqësore ose pretendimi që jsnë në dijani, së bashku me vlerësimin e rezultatit të një çështje të tillë dhe vlerësimin financiar të ndikimit të rastit.

Nëse konsiderohet se nuk ka shumë gjasa që këshilltarët ligjor të përgjigjen në kërkesat e letrësm psh nëse në ndonjë formë është e ndaluar që avokatët të komunikojnë direkt me auditorët, atëherë auditori mund të kërkojë komunikim për çështje specifike siç janë:

- (a) Një listë të pretendimeve dhe çështjeve gjyqësore të hapura;
- (b) Nëse është në dispozicion, vlerësimi i menaxhmentit për rezultatet e secilës çështje dhe vlerësimi i implikimeve financiare, përfshirë kostot; dhe
- (c) Një kërkesë që këshilltarët ligjor të entitetit të konfirmojnë arsyeshmërinë e vlerësimeve të menaxhmentit dhe ofrojnë informata të mëtutjeshme nëse listat e ofruara të informatave nga menaxhmenti konsiderohet e jo e plotë ose e pasaktë.

Në raste të caktuara, auditori mund të konsiderojë të takohet me këshilltarët ligjor të entitetit për të diskutuar rezultatet e ndonjë çështje gjyqësore ose pretendimi. Kjo mund të ndodhë nëse:

- Auditori përcakton se çështja përbën rrezik domethënës.
- Çështja është komplekse.
- Ka mosmarrëveshje në mes të menaxhmentit dhe këshilltarëve ligjor.

Zakonisht, takimet e tilla kërkojnë pajtimin nga menaxhmenti dhe mbahen në praninë e përfaqësuesve të menaxhmentit.

b. i) *nëse nuk dëshirojnë të shqetësojnë avokatët e tyre me kërkesa - ky nuk është argument valid por një arsytim i pabazuar;*

ii) *ata do të nënshkruajnë një letër të përfaqësimit që përmban një paragraf që adreson çështjen në mënyrë të mjaftueshme – SNA 580 Përfaqësimet e shkruara deklarohen, ' Edhe pse përfaqësimet e shkruara pofrojnë dëshmi të nevojshme të auditimit, ato në vete nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshatshme të auditimit. Përveç kësaj, fakti që menaxhmenti ka ofruar përfaqësime të besueshme nuk ndikon në natyrën ose shtrirjen e dëshmive tjera të auditimit të cilat auditori i përfton lidhur me përmbushjen e përgjegjësiive të menaxhmentit për pohimet specifike. Prandaj ky argument nga menaxhmenti nuk është i vlefshëm.*

iii) *të gjitha detyrimet kontigjente janë shpalosur në tërësi në shënimet e pasqyrave financiare - shënimet e pasqyrave financiare përfshijnë pohime dhe përfaqësime të bëra nga menaxhmenti. Përgjegjësia e auditorit është të ekzaminojnë këto pohime dhe përfaqësime. SNA 501 thekson "auditori duhet të dizajnojë dhe kryejë procedura të auditimit për të identifikuar çështjet gjyqësore dhe pretendimet që përfshijnë entitetin të cilat mund të rrisin rrezikun e anomalive material, përfshirë:*

- (a) Bisedat me menaxhmentin dhe me këshilltarët ligjor, nëse është e aplikueshme;
- (b) Rishikimi i procesverbaleve të takimeve të bordit dhe korrespondencat në mes të entitetit dhe këshilltarëve ligjor; dhe
- (c) Rishikimi i llogarive të shpenzimeve ligjore.

Prandaj, ky argument nuk është i vlefshëm.

iv) *nuk ka kërkesa ligjore që të dërgohet një letër e tillë* – varësisht nga vendi në të cilin operon auditori, kjo mund të jetë çështje e diskutueshme. Megjithatë në Kosovë pasi që SNA kërkohen me ligj, atëherë pajtueshmëria me SNA është çështje që kërkohet me ligj.

c.

Nëse

(a) menaxhmenti refuzon të lejojë auditorin të komunikojë me këshilltarët ligjor të entitetit, ose nëse këshilltarët e jashtëm ligjor refuzojnë të përgjigjen në letrën e auditorit, ose e kanë të ndaluar të përgjigjen; dhe

(b) auditori nuk është në gjendje të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit përmes procedurave alternative, **auditori duhet ta modifikojë raportin e auditorit në pajtueshmëri me SNA 705.**

Në pajtueshmëri me SNA 700, nga auditori kërkohet të datojë raportin jo më herët se para se të ketë përfutur dëshmi të auditimit mbi të cilat e bazon raportin e auditimit për pasqyrat financiare. Dëshmitë e auditimit për statusin e çështjeve gjyqësore deri në datën e raportit të auditimit mund të përftoheshin përmes bisedave me menaxhmentin, përfshirë këshilltarët e brendshëm ligjor, që janë përgjegjës për çështjet në fjalë. Në disa raste, auditori duhet të përftojë informata të azhurnuara nga këshilltarët e jashtëm ligjor.